

GJUHA SI NJË E MIRË KULTURORE THEMELTARE PËR TRASHËGIMINË

Dr. ELSA SKËNDERI

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë
Universiteti i Tiranës
elsa.skenderi@unitir.edu.al

Msc. ANXHELA LEPURI

anxhela.lepuri@Af.edu.al
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë
Universiteti i Tiranës

ABSTRACT

The present paper aims to analyse the concept of language as a cultural asset. Language is the central tool for preserving identity, but also for the authenticity and the survival of a culture. Languages are inherent parts of the cultural and intellectual world and as such, the disappearance of a language is not simply the disappearance of a linguistic code in and of itself, but the disappearance of a world view and cultural universe. Language, in addition to being a means of communication, also shapes and reinforces identity, it communicates culture and many of the inheritors consider it an irreplaceable sign of identity. Taking back some concepts of the philosophy of language and ethnolinguistics, in this study will be argued the role of language in general and heritage languages in particular, as cultural assets for the preservation and transmission of cultural heritage from generation to generation, especially in the context of the developments that have brought globalism.

Keywords: ethnolinguistics, ethnolinguistic vitality, cultural heritage, heritage language.

1. Gjuha dhe këndvështrimi për botën

Gjuha është mjeti qendror për komunikimin dhe përfaqësimin e një sërë aspekteve botëkuptimore, përfshirë këtu edhe kulturore të një komuniteti të caktuar folësish. Ajo është po ashtu thelbësore për identitetin,

autenticitetin dhe mbijetesën e një kulture të caktuar. Prej kohësh është pranuar fakti që gjuhët diktojnë mënyrën tonë të të parit të botës, qëndrim që është konsoliduar nën ombrellën e determinizmit linguistik, njohur ndryshe edhe me emrin hipoteza e Sapir-Whorf-it, hipotezë sipas së cilës struktura gjuhësore *determinon* këndvështrimin për botën.

Përkundër qasjes së gjuhësisë autonome¹, qasja sociolinguistike i mëshon faktit që gjuha nuk mund të studiohet në mënyrë të pavarur nga shoqëria në të cilën ajo gjëllin. (Shih Newman 1987, 105). Në të njëjtën hulli nga perspektiva e teorisë kritike Watson-Gegeo dhe Gegeo (1999), theksojnë se gjuha është qendrore për mënyrat kulturore të të menduarit: “gjuha është themelore për identitetin, autenticitetin, mbijetesën kulturore për proceset e të menduarit dhe të mësuarit të njerëzve” (25).

Gjuhët janë pjesë themeltare e trashëgimisë kulturore dhe intelektuale ku është depozituar gjithë universi botëkuptimor e kulturor i njerëzimit. Në këtë pikëpamje gjuha duhet konsideruar si e mirë kulturore. Çdo gjuhë si e mirë kulturore gëzon funksion të dyfishtë, funksionin instrumental dhe funksionin simbolik. Gjuha kryen funksionin instrumental teksa shërben si mjet komunikimi për komunitetin e folësve, ndërsa funksion simbolik, teksa shërben si “emblemë grupi, simbol dhe pikëtakim psiko-social” (Edward 2009, 55). Gjuhët, duke u sendërtuar si konstrukte sociale, shenjojnë identitetin kolektiv të një grupi të ngushtë brenda komunitetit, por edhe më tej identitetin e gjithë kombit.

Lidhjen midis gjuhës, si shenjë identitare, dhe kombit e patën në qendër të vëmendjes veçanërisht studimet në kapërcyell të romantizmit, që u zhvillua nën ombrellën e nacionalizmit. Kështu studimet e Boppit, të Shlegelsit, Vëllezërve Grimm, mëtonin të hidhnin dritë mbi lidhjen mes gjuhës, kulturës e dijes (Grossman 1997, 25). Në këtë hulli spikat mendimi gjuhësor i filozofit W. V. Humboldt, të cilit i atribuohet koncepti i *këndvështrimit për botën*, që folësve iu vjen përmes *organit të ligjërit* (i.e. gjuhës). Individit e formëson dhe formësohet në vijimësi nga gjuha, sipas filozofisë së gjuhës humboldiane, gjuha është edhe përpjekja krijuese, që zhvillohet në vijimësi, e një kulture (Underhill 2009, x-xi). Për Humboldt-in gjuha si *energia* (energji) dhe jo thjesht

¹ Term që përdoret për të treguar qasjet që e studiojnë gjuhën në vetvete dhe për vetvete, tipikisht gramatika gjenerative transformuese si dhe strukturalizmi

si *ergon* (produkt), parakuptonte një ndërlidhje të drejtpërdrejtë mes kulturës, gjuhës dhe mendjes.

“Ajo që e intrigonte Humboldtin ishte lidhja e trefishtë që ekzistonte mes mendjes, gjuhës dhe *Bildung*²-ut, (aventura e vijueshme e kultivimit të kombit). Kultura qartësisht konceptohet nga Humboldt si *kultivim* dhe zhvillim i njeriut. [...] Ky proces kultivimi përfshin tri forca ndërvepruese: kultivimin e vetes, kultivimin e mendjes së njerëzimit dhe kultivimin e gjuhës. Përderisa gjuha është organi i mendimit, ajo jo thjesht reflekton përparimet në mendim, por i manifeston ato, i trupëzon më tej; iu jep atyre *formë*. Dhe përderisa as gjuha as mendja nuk ekzistojnë më vete në abstraksion, është vetëm përmes punës së mendjeve individuale që realizohen si kultura si përparimi në të menduar e në gjuhë. (Underhill 2009, 65).

Për Humboldtin gjuha është shprehëse e shpirtit të kombit, pasi nëpërmjet gjuhës mund të mbërrijmë te karakteri kombëtar. “Gjuha e kombit është shpirti i tij dhe shpirti i tij është gjuha e tij” (Humboldt, i cituar në May, 2013, 61). Filozofi gjerman shprehet se në sajë të gjuhës si instrument i zhvillimit të individit, “karakter i kombit mund të njihet më mirë së brendshmi përmes dokeve, zakoneve dhe veprave. Për këtë arsye popujt që kanë mungesë literature, dhe përdorimet gjuhësore të cilat nuk shkojnë mjaftueshëm thellë, shpesh na duken më të njëtrajtshëm nga sa janë. Ne nuk i njohim tiparet e tyre dalluese, sepse ato nuk na kumtohen përmes mediumit, që do të na lejonte t’i shihnim” (Humboldt 1999, 153).

Filozofia e gjuhës e Humboldtit ka çelur hullinë e një sërë koncepteve dhe këndvështrimeve që janë sot e gjithë ditën të shfrytëzueshme, veçanërisht prej atyre që e shohin gjuhën si jetike për vitalitetin etnolinguistik dhe shumësinë e komuniteteve etnolinguistike si pasuri universale të gjithë njerëzimit. Qasja etnolinguistike merr një rëndësi të veçantë, sot kur shumë gjuhë e kultura rrezikohen të humbasin tiparet e tyre dalluese dhe të bjerren si pasojë e trysnisë së vazhdueshme të globalizmit dhe efekteve të tij ndaj gjuhëve e kulturave më të vogla. Gjuhët janë pjesë e trashëgimisë kulturore dhe intelektuale dhe si të tilla, bjerria e një gjuhe nuk është thjesht zhdukje e një kodi gjuhësor

² Underhill-i (2009, 65), shprehet se termi *bildung*, përgjithësisht është përkthyer si edukim, kultivim, ose formim kulturor.

në vetvete dhe për vetvete, por zhdukja e një universi botëkuptimor e kulturor. Gjuhëtari Ken Hale (1992, 1), shprehet se humbja e gjuhëve në këtë epokë është pjesë e një procesi edhe më të gjerë humbjeje të diversitetit kulturor e intelektual, ku gjuhët e kulturat politikisht dominuese i vendosin gjuhët e kulturat lokale indigjene, në situata pragbeteje. Hale e përfaqëson procesin me humbjen e diversitetit biologjik në Tokë. Këtë përplasje mes gjuhëve dhe kulturave, Tove Skutnabb-Kangas (2001) e konsideron si luftë të identitetit, që në thelb, sipas tij është luftë për shfrytëzimin e resurseve natyrore, me pasoja shumë të rënda, pasi sipas tij “dija kulturore, e koduar në diversitetin e gjuhëve të botës, është një parakusht i nevojshëm për mirëmbajtjen e qëndrueshme të burimeve natyrore; gjuhët janë po ashtu një parakusht për transferimin ndërbrezor të asaj dijeje” (203).

Në të njëjtën brazdë, Underhill (2009) thekson se situata e diversitetit linguistik është shqetësuese po të kemi parasysh përlllogaritjen se çdo dy javë vdes një gjuhë, e cila është produkt i shekujve të tërë mendimi e ndjenje, çka ngjan me “djegien e një librerie të një kulture, shpesh pa qenë shkruar fare” (ix). Asimilimi kulturor sipas tij bëhet edhe më i rrezikshëm nëse shpërfilllet nga institucionet, të cilat qëndrojnë indiferente ndaj diversitetit dhe të verbra ndaj gjithë asaj që kulturat dhe gjuhët e tjera kanë për të ofruar. Në nivel ndërkombëtar disa organizma me peshë siç, është rasti i UNESCO-s, duket që gjithsesi kanë nisur të reagojnë në drejtim të ruajtjes së kulturave dhe të gjuhëve të rrezikuara, siç edhe do ta shohim në vijim të këtij punimi.

2. Qasja etnolinguistike ndaj gjuhës si e mirë kulturore

Në historinë e mendimit teorik gjuhësor rast pas rasti, objekt studimi parësor është konsideruar gjuha si sistem në vetvete dhe për vetvete, pa pasur parasysh lidhjen e ndërsjellë të gjuhës me kulturën. Arsytet për këtë mënjanim të shqyrtimit të dikotomisë gjuhë-kulturë, janë të shumta dhe lidhen kryesisht me ndikimin e fortë që pati në gjuhësinë e shek. XIX, prirja pozitiviste për të konsideruar si kryekëput shkencore vetëm metodat e shkencave të natyrës. Veçanërisht në mes të shekullit, teksa rrekeshin të përvijonin një disiplinë autonome dhe të dallueshme nga pedagogjia, letërsia apo filozofia, etërit e *gjuhësisë*

historiko-krahasuese mbanin qëndrime “pozitiviste” të nxitura edhe nga Filozofia e Natyrës e Hegelit. Kësisoj, J. Grimm-i në parathënien e Gramatikës së tij Gjermane, shprehej se, në mënyrë që gjuhësia ta meritonte të quhej shkencë, duhej të ndiqte arritjet dhe metodat e anatomisë së krahasuar. Në të njëjtën hulli, F. Bopp-i do të shkruante se gjuhët duheshin konsideruar si trupa natyrorë organikë dhe se gramatika, në një kuptim shkencor, ishte përshkrimi i natyrës së një gjuhe (Skënderi Rakiplari 2021). Trysnia e pozivizmit bëri që për një pjesë çdo gjë që nuk mund të identifikohet në terma të fonologjisë, morfologjisë dhe sintaksës konsiderohej “jashtëgjuhësore”, dhe si rrjedhojë përtej kompetencave të gjuhëtarit. Dhe madje edhe vetë kuptimi nga shumë gjuhëtarë është konsideruar si jashtëgjuhësor, për faktin se nuk mund të analizohej në bazë të të njëjtave metoda formaliste, sipas të cilave analizohej struktura e frazës. Strukturalistët qenë ata që nuk e morën aspak në konsideratë aspektin antropologjik të gjuhës, prej Bloomfield-it e deri tek Martineja, i ngurtësuan akoma më tepër metodat, për të mos u marrë me kuptimin dhe semantikën (Harris 1993, Cardona, 2006; Underhill, 2012).

Këtë tryzni të pozitivizmit e vërejmë edhe te Sosyri, i cili shprehej se në trikotominë *language, Langue, parole*, studiuesit duhet të merreshin me gjuhën, si sistem i qëndrueshëm dhe jo me ligjërimin, që përbënte një terren të rrëshqitshëm subjektiviteti. Gjuha lipsej studiuar “si sistem *in se* dhe *per se*, jashtë kohe, larg ndikimit të folësit, i cili mendohej se nuk siguronte vijueshmërinë e fakteve të gjuhës dhe larg ndikimit të “subjektivizmit” edhe të vetë gjuhëtarit. Pas revolucionit në mendimin gjuhësor, që solli Teoria e gramatikës gjenerative e N. Çomskit, i cili nuk ndalej sërish te ligjërimi, në termat e Çomskit *performanca*, por te kompetenca gjuhësore, një aftësi gjuhësore e lindur, me natyrë sintaksore dhe universale, që përvijonte konceptin e folësit të abstraguar ideal, dhe jo të folësit konkret, apo të realizimeve konkrete gjuhësore.

Por nuk do të vononte shumë dhe studiuesit do të vetëdijesheshin se në fakt “gjuha kumton kulturë” (Calvet 1998, 2) dhe se më e rëndësishme se kompetenca gramatikore është *kompetenca e ligjërimin* (e komunikimit), koncept ky i zhvilluar nga etnolinguisti, D. Hymes. Për Hymes-in (1972) nëse nuk mbahet parasysh situata ligjërimore, konteksti dhe faktorët socio-kulturorë, fjalitë e ndërtuara krejtësisht

saktë nga pikëpamja gramatikore nuk do të kenë asnjë vlerë në tregun ligjërimit.

Përherë e më tepër, gjuhëtarët po vetëdijesheshin se gjuha nuk mund të studiohej e izoluar nga kultura në të cilën flitet. Në të njëjtën kohë antropologët kuptuan se nuk mund të ketë studim të mjaftueshëm të sistemeve kulturore pa studiuar gjuhën (*shih* Witherspoon 1980). Pikëtakimi i këtyre dy disiplinave i çeli udhë të ashtuquajturës gjuhësi antropologjike, të njohur edhe me termin etnolinguistikë.

Themelimi i një gjuhësie me thelb antropologjik, pra i asaj discipline që sot e quajmë etnolinguistikë³, i detyrohet pikërisht dy antropologëve, Boas-it dhe Malinowski-t, dhe ka si qëllim parësor studimin e marrëdhënies mes gjuhës dhe kulturës, dhe mënyrën sesi grupe të ndryshme etnike e perceptojnë botën, dhe përveç kulturave të largëta, interesohet edhe për ato të afërta, do të shprehet etnolinguisti Giorgio Raimondo Cardona (2006, 5), në librin *Hyrje në etnolinguistikë*. Në të njëjtën vijë mendimi është edhe gjuhëtari James W. Underhill (2012), i cili në librin *Etnolinguistika dhe konceptet kulturore, e vërteta, dashuria, urrejtja dhe lufta*, rreket të trajtojë se si konceptet si dashuria, urrejtja apo lufta perceptohen në kultura të ndryshme, duke dalë në përfundimin se gjuha i jep formë mendimit të grupeve etnike, dhe si rrjedhojë individët kanë një rol kyç në konsolidimin e koncepteve kulturore.

Gjuha është forca themeltare e jetës së një komuniteti duke mundësuar ndërveprimin mes anëtarëve të një shoqërie, të cilët e përdorin atë për të kryer një sërë veprimtarish e funksionesh, mes të cilëve mund të përmendim edukimin e pasardhësve. Fëmijët duke përvetësuar gjuhën përvetësojnë edhe kriteret organizuese, rregullat e sjelljes, normat e ndërveprimit, mënyra të caktuara të të menduarit, parime ideologjike që rregullojnë mënyrën se si funksionon shoqëria. Siç e theksuam edhe më lart, kultura nuk trashëgohet gjenetikisht dhe nuk mund të ekzistojë e izoluar, por jetësohet teksa anëtarët e komunitetit e konsiderojnë si një “enë mbajtëse” (Hall, 1997), ku depozitohen vlerat dhe domethëniet e kulturës. Underhill (2012) thekson se ne jemi po aq prodhues të gjuhës, sa edhe produkte të saj.

³ Përveç termit ‘etnolinguistikë’ kjo disiplinë shpesh është emërtuar edhe ‘gjuhësi antropologjike’, sidomos në Amerikën veriore te viteve ’50. Në dekadat e fundit, nën ndikimin e studiuesit Dell Hymes, ka fituar terren edhe termi ‘etnografi e të folurit’. Ndonëse termi ‘etnolinguistikë’ është afirmuar më së tepërmi edhe për ta përqasur këtë disiplinë edhe me terma të tjerë homologë, si: etnomuzikologji, etnohistori, etnosemantikë.

3. Vitaliteti etnolinguistik dhe gjuha e trashëgimisë

Për komunitetet etnolinguistike gjuha ka rol jetik për të garantuar vijmësinë dhe unitetin brenda secilit komunitet. Ndaj ruajtja e gjuhëve si nga ana historike edhe nga ana kulturore është një çështje tepër e rëndësishme, veçanërisht për ato komunitete që janë në situata jo aq të favorshme për ta ruajtur identitetin e vet etnolinguistik. Në këtë syth do të trajtojmë konceptin e gjuhësisë trashëgimisë dhe të vitalitetit etnolinguistik që ato mund të shfaqin, në varësi të rrethanave në të cilat gjëlljnë.

Siç e tregon termi, me gjuhë të trashëgimisë kuptohen gjuhët e trashëguara nga njëri brez te tjetri, çka në thelb ndodh me të gjitha gjuhët, por gjuhë të trashëgimisë përgjithësisht konsiderohen gjuhët e pakicave kulturore dhe etnogjuhësore, që zhvillohen në një mjedis dygjuhësh, ku status më të lartë ka një gjuhë tjetër. Folësit e gjuhëve të trashëgimisë janë anëtarë të një pakice gjuhësore, të cilët përveç gjuhës së tyre amtare, pra gjuhës së trashëgimisë, jetojnë të ekspozuar edhe ndaj një gjuhe tjetër zyrtare, që ka shtrirje më të madhe në komunitetin ku ata jetojnë e veprojnë (Montrul 2016, 2).

Montrul (2016) thekson se “gjuha e trashëgimisë është gjuhë amtare, ndonëse jo gjithmonë mund të ngjajë si e tillë” (4). Ndryshe nga gjuha zyrtare, gjuha e trashëgimisë nuk është e tillë dhe nuk ka një njohje dhe as shpërndarje të gjerë; gjen pak ose aspak përdorim në media dhe medime të tjera publike dhe përdoret në pak raste në administratë apo arsimim. Ndonëse gjuha e trashëgimisë nuk përdoret gjerësisht si mjet komunikimi aktiv, ajo shërben për folësit e komunitetit të saj si një simbol identitar, duke u bërë mishërim i etnicitetit, që ia kujton grupit a komunitetit në fjalë trashëgiminë e tij kulturore (Giles, Bourhis, Taylor 1977, 307). Gjuhët e trashëgimisë shihen si të mira publike, kulturore dhe përbashkuese edhe prej atyre të cilët nuk kanë një njohje shumë të mirë të tyre, por pavarësisht kësaj janë të vetëdijshëm për rëndësinë që ato kanë.

Aftësia që një grup tregon për të ruajtur dhe mbrojtur ekzistencën e tij në rrjedhën e kohës, si një entitet kolektiv me një identitet dhe gjuhë të veçantë konsiderohet si vitalitet etnolinguistik. Sipas Giles, Bourhis dhe Taylor (1977), vitaliteti i një grupi etnolinguistik është “çka e bën një grup të caktuar të sillet si një entitet kolektiv aktiv dhe

i dallueshëm në situata ndërgrupore. [...] pakicat etnolinguistike që kanë pak ose aspak vitalitet mund të rreshtin së ekzistuari si grupe të dallueshme; sa më shumë vitalitet të ketë një grup gjuhësor, aq më shumë ka gjasa që ai të mbijetojë dhe të ekzistojë si entitet kolektiv në një kontekst ndërgrupor (308-9).

Vitaliteti etnolinguistik ka të bëjë me transferimin ndërbreznor të gjuhës dhe të praktikave kulturore të një grupi, qëndrueshmërinë, kohezionin social dhe lidhjen emocionale që anëtarët e grupit kanë në raport me identitetin e tyre kolektiv. Në të mirë të interesave të grupit në një kontekst bashkekzistence me grupe të tjera, grupet me vitalitet të lartë dëshmojnë aftësi për të ndërvepruar në mënyrë kolektive, ndërsa grupeve me vitalitet të ulët iu mungon kjo lloj aftësie dhe janë të prirur për t'u asimiluar (Ehala, 2010:1). Prirja e individëve për ta ruajtur ose jo gjuhën e tyre të trashëgimisë, varet nga kushtet shoqërore, ekonomike që diktojnë mbijetesën e grupit, por edhe nga fakti nëse ata e perceptojnë gjuhën si shenjë themelore të identitetit.

Faktorët që mund të ndikojnë në bjerren e gjuhës së trashëgimisë janë të shumëllojshëm, si në nivelin makroshoqëror, ashtu edhe në atë mikroshoqëror. Arsyt kryesore që mund të ndikojnë në ndryshimin e gjuhës në nivelin makroshoqëror janë industrializimi, urbanizimi, migrimi etj., ndërsa në nivel mikroshoqëror janë zgjedhjet dhe qëllimet individuale të folësve. Arsyt e zgjedhjes së një gjuhe në raport me një tjetër janë shpesh komplekse dhe të kombinuara. Arsyeja kryesore dhe më e përligjur është ajo e komunikimit; individët do të zgjedhin dhe përvetësojnë atë gjuhë, e cila ua lehtëson komunikimin në shoqërinë ku ata jetojnë.

Edwards (1985) shprehet se zgjedhja e një kodi gjuhësor dhe konkretisht ndryshimi i gjuhës është i lidhur me vendimet pragmatike që individët marrin, teksa një varietet e shohin si më të rëndësishëm për të ardhmen e tyre. Emigrantët ose folësit e gjuhëve minoritare përgjithësisht zgjedhin të përvetësojnë gjuhën që ka përdorim më të gjerë dhe kjo lidhet pashmangshmërisht me arsyet ekonomike. Gjuhët e trashëgimisë rrezikohen të bjerren edhe për shkak të bindjeve që folësit kanë ndaj gjuhës së trashëgimisë; nëse askush nuk i përkushtohet mësimi dhe ruajtjes së këtyre gjuhëve, grupi kolektiv i folësve zvogëlohet dhe zinxhiri i transmetimit midis brezave mund të priset.

Nëse një gjuhë nuk përdoret në institucione arsimore dhe jashtë mjedisëve të shtëpisë, ajo nuk do të dëgjohet dhe përdoret aq shumë prej folësve të saj, sepse ata nuk do t’ia ndiejnë më nevojën dhe nuk do t’ia shohin më vlerën. Folësit e gjuhëve të trashëgimisë përgjithësisht janë fëmijët e emigrantëve, të cilët mund të jenë zhvendosur në një shtet tjetër me prindërit e tyre gjatë fëmijërisë, ndërsa të tjerët lindin në vendin e ri dhe si rrjedhojë janë të ekspozuar ndaj gjuhës së trashëgimisë dhe gjuhës së vendit pritës që nga lindja. Fëmijët e emigrantëve të parë janë brezi i dytë dhe rriten në një kontekst dygjuhësh. Fëmijët e tyre, pra të gjeneratës së dytë (dhe nipërit e gjeneratës së parë) janë brezi i tretë dhe konsiderohen gjithashtu folës të gjuhës së trashëgimisë, nëse ende kanë njohuri rreth saj, por është pikërisht kjo fazë, sqaron Montrul (2016, 24), ku nis të bjerret gjuha e trashëgimisë.

4. Rëndësia e gjuhës si një e mirë kulturore në kuadrin ligjor të UNESCO-s

Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO), gjatë funksionimit dhe veprimtarisë së vet, e vë theksin te ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore, duke theksuar ndër të tjera dhe rëndësinë që ka konsiderimi i gjuhës si një e mirë kulturore. Në kushtetutën e UNESCO-s pohohet se kjo organizatë mbështet pagën dhe sigurinë, duke promovuar bashkëpunimin midis vendeve [...], pavarësisht racës, gjinisë, gjuhës dhe fesë. Por, me të drejtë, studiuesit vërejnë se në fakt UNESCO nuk mbron drejtpërdrejt gjuhën, por ato raste specifike kur gjuha është mjeti për ekzistencën e formave të trashëgimisë jomateriale (De Witte 2020, 372). Gjithsesi ky boshllëk ligjor formal plotësohet disi me anë të një sërë dokumenteve të tjera të rëndësishme të këtij institucioni.

Për shembull, *Deklarata Universale e UNESCO-s për Diversitetin Kulturor* (2001) thekson lidhjen thelbësore midis diversitetit kulturor dhe diversitetit gjuhësor, e cila synon:

1. të mbështesë diversitetin gjuhësor të njerëzimit dhe të mbështesë shprehjen, krijimin dhe përhapjen e sa më shumë gjuhëve;

2. të nxisë diversitetin gjuhësor në të gjitha nivelet e arsimit, ku është e mundur, dhe të nxisë mësimin e gjuhëve të ndryshme që në moshë të re;

3. të përfshijë, aty ku është e përshtatshme, pedagogjinë tradicionale në procesin edukativo-arsimor, me qëllim që të ruhen dhe të shfrytëzohen plotësisht metodat kulturore të përshtatshme të komunikimit dhe transmetimit të njohurive; dhe aty ku lejohet nga komuniteti folës, duke inkurajuar aksesin universal në informacionin e domenit publik në të gjithë rrjetin global, duke përfshirë promovimin e diversitetit gjuhësor në hapësirën kibernetike (UNESCO, 2001).

Poashtu, UNESCO ka realizuar në vijimësi aktivitete ndërgjegjëse dhe konservuese për gjuhët e rrezikuara, duke theksuar nevojën që kërkimi shkencor në këtë fushë të jetë jo vetëm përshkrues, por edhe ndikues për rigjallërimin e këtyre gjuhëve, si në rastin e projektit “Atlasi i Gjuhëve në rrezik të botës” (Moseley, UNESCO 2010). Kësisoj, gjuha konsiderohet si pasuri kulturore e dyfishtë, si një dëshmi në vetvete dhe si një dëshmi e pasuri për komunitetin e folësve, pasi në të është depozituar e gjithë qasja e këtij komuniteti ndaj realitetit kujtesa e tij kulturore dhe historike, të tilla si format e artit gojor, përrallat, rapsoditë, tregimet, poezitë, etj.

5. Gjuha si mjet i trashëgimisë kulturore jomateriale

Më 17 tetor 2003 në Paris u miratua *Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale*, gjatë sesionit të 32-të të Konferencës së Përgjithshme të UNESCO-s. Kjo Konventë ka ndihmuar në zhvillimin e politikave ndërkombëtare, që synojnë promovimin e diversitetit kulturor, duke njohur nevojën për të mbështetur shprehjet kulturore, që deri atëherë nuk kishin përfituar nga një kuadër ligjor kaq i rëndësishëm. Konventa krijoi një paradigmë të re në mbrojtjen e trashëgimisë, e sidomos për sa i përket politikëbërjes dhe ligjeve në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar, duke ridimensionuar qasjen ndaj trashëgimisë dhe komuniteteve të trashëgimisë. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore jomateriale ka qenë një çështje e rëndësishme për shumicën e vendeve dhe njerëzve anëmbanë globit shumë kohë përpara se të miratohej Konventa e vitit 2003, e cila iu përgjigj nevojave aktuale të shumë shteteve anëtare të UNESCO-s, dhe disa prej prioriteteve të politikave ndërkombëtare, që ndiheshin fuqishëm në atë kohë dhe vazhdojnë të ndihen po njëjloj edhe sot. Në veçanti,

përvoja e vendeve që janë pjesë e Konventës (2003) tregon qartë se, për shumë prej tyre, trashëgimia kulturore jomateriale në format e saj të ndryshme është një burim i pasur social, ekonomik dhe madje politik që ofron një shumëllojshmëri rrugësh të mundshme drejt modeleve të qëndrueshme të zhvillimit (Blake, 2016b:11).

Ndër qëllimet e Konventës gjejmë:

(a) Ruajtja e trashëgimisë kulturore jomateriale;

(b) Sigurimi i respektimit të trashëgimisë kulturore jomateriale nga komunitetet, grupet dhe individët;

(c) Ndërgjegjësimi vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar për rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale

(d) Promovimi i bashkëpunimit dhe mbështetjes ndërkombëtare.

Më tej, në Artikullin 2 nënvizohet se me “trashëgimi kulturore jomateriale” kemi parasysh praktikën, përfaqësimet, shprehjet, njohuritë, aftësitë, si dhe instrumentet, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore që lidhen me to, që komunitetet, grupet dhe, në disa raste, individët i njohin si pjesë të trashëgiminë e tyre kulturore. Kjo trashëgimi kulturore jomateriale, e transmetuar nga brezi në brez, rikrijohet vazhdimisht nga komunitetet dhe grupet në përgjigje të mjedisit të tyre, ndërveprimit të tyre me natyrën dhe historinë e tyre dhe u siguron atyre një ndjenjë identiteti dhe vazhdimësie, duke promovuar kështu respektin për diversitetin kulturor dhe krijimtarinë njerëzore (UNESCO, 2003).

Trashëgimia kulturore jomateriale gjen shprehje, ndër të tjera në traditat dhe praktikën gojore, duke përfshirë gjuhën si mjet të trashëgimisë kulturore jomateriale, artet skenike, praktikën sociale, ritualet dhe ngjarjet festive, njohuritë dhe praktikën në lidhje me natyrën dhe universin dhe gjithashtu në mjeshtëritë tradicionale (UNESCO, 2003). Gjuha është thelbësore, sepse shërben si mjeti më i mirë për ndërveprim mes folësve, të cilët si rrjedhojë janë edhe ruajtës të saj. Pothuajse të gjitha shprehjet, aktivitetet dhe paraqitjet bëjnë pjesë në këtë kategori. Forma të tjera jomateriale të shprehjes përfshijnë muzikën, gjestet dhe mimikën. Në metodat tradicionale të përcjelljes së trashëgimisë kulturore jomateriale nga brezi në brez, gjuha dhe gjestet janë po aq mjete të rëndësishme sa vetë kjo trashëgimi.

Përcaktimi i politikave gjuhësore është një çështje mjaft delikate për shumë shtete shumëgjuhëshe, veçanërisht për ato ku gjuha

kombëtare konsiderohet si faktor unifikues (Smeets, 2004; Blake, 2016a). Si rezultat, kjo çështje pati krijuar debate gjatë negociatave ndërqeveritare, sidomos në ato shtete të cilat i trembeshin rëndësisë së madhe që mund t'iu jepej gjuhëve të pakicave, çka si rrjedhojë mund të sillte shkëputjen e tyre nga vetë shteti (Wright, 2001). Formulimi i tekstit të traktatit përfaqëson një kompromis, ku në pjesën e parë të përkufizimit të trashëgimisë kulturore jomateriale (përcaktuar në artikullin 2), theksohet se trashëgimia kulturore jomateriale manifestohet në traditat dhe shprehjet gojore, duke përfshirë gjuhën si mjet i trashëgimisë kulturore jomateriale. (UNESCO, 2003). Kjo sinjalizon vullnetin për të pranuar rëndësinë që ka gjuha për ruajtjen e shumë llojeve të trashëgimisë kulturore jomateriale, duke shmangur çdo formulim, që do të kërkonte mbrojtjen dhe promovimin e gjuhëve të pakicave si trashëgimi kulturore jomateriale (Blake, 2016a: 75).

Blake-u, thekson se në funksion të kësaj polemike, disa shtete palë të Konventës (kryesisht të Amerikës Latine dhe Afrikane), tani e konsiderojnë gjuhën si pjesë të trashëgimisë kulturore jomateriale, çka tregon se praktika e palëve për zbatimin e Konventës së vitit 2003, po e zhvendosin gradualisht traktatin drejt një teme që ishte lënë jashtë draftit përfundimtar të tij. I tillë, sipas Blake-ut, është rasti i disa shteteve palë, që kanë vendosur t'i konsiderojnë gjuhët si pjesë të trashëgimisë kulturore jomateriale teksa bëjnë inventarizimin e saj në nivel kombëtar.

Arkivistë apo aktivistë të gjuhës si e mirë kulturore?

Ajo që do t'i vinte në ndihmë ruajtjes dhe mbrojtjes së gjuhës, pa dyshim lidhet me kultivimin dhe menaxhimin e saj (*shih* Spolsky 2005). Bernard Spolsky (2005, 264-265) shprehet se ky i fundit, menaxhimi i gjuhës, është mjaft sfidues për një sërë faktorësh, mes të cilëve: - mosmarrja në konsideratë e faktit që menaxhimi i gjuhës përmes politikave gjuhësore, ashtu si menaxhimi i sektorëve të tjerë si ekonomia, shëndetësia etj., është proces tepër i ndërlikuar, që merr shumë kohë dhe ka kosto të mëdha financiare. Krahas kësaj, suksesi i një politike gjuhësore duhet parë nga disa nivele: niveli i familjes, niveli i institucioneve fetare, niveli i biznesit dhe tregtisë. Të gjitha këto nivele kanë specifikat e tyre sa iu takon praktikave ligjërimore,

ideologjive gjuhësore e besimet gjuhësore që shfaqin dhe që sigurisht e ndikojnë pashmangshëm menaxhimin gjuhësor. Një tjetër faktor, sipas Spolsky-t, që e bën sfidues menaxhimin gjuhësor ka të bëjë me një moskoordinim dhe dështim në komunikim midis politikanëve dhe administratorëve të programeve të menaxhimit nga njëra anë dhe ekspertëve gjuhësorë nga ana tjetër.

Ruajtja e gjuhës si një e mirë kulturore shumëpërmasore, por edhe e trashëgimisë kulturore, me gjasë, kërkon shumë më tepër se thjesht përshkrim (për çka bën thirrje disiplina racionale gjuhësore sot, që devizën e ka ‘përshkrim dhe jo preskriptivizëm’). Me fjalët e gjuhëtarit nordik T. Skutnabb-Kangas (2001, 214), tani koha është që përveç asaj që kanë bërë deri më sot, katalogim dhe përshkrim të diversitetit gjuhësor, gjuhëtarët ta lënë mënjane purizmin akademik dhe naivitetin; *të bëhen aktivistë*, krahas të qenit arkivistë.

BIBLIOGRAFIA

- BLAKE, J., (2016), “Creating a new heritage protection paradigm?” *The Routledge companion to intangible cultural heritage*, a: 11.
- BLAKE, J., (2016), “The impact of UNESCO’s 2003 Convention on national policy-making: developing a new heritage protection paradigm?” *The Routledge Companion to Intangible Cultural Heritage*. Routledge, b. 93-102.
- CALVET, L. J., (1998), *Language wars and linguistic politics*. Oxford University Presson Demand,.
- CARDONA, G. R., (2006), *Introduzione all’etnolinguistica*, UTET,.
- DE WITTE, B., (2020), “Language as cultural heritage.”
- EDWARDS, J. R., (1985) *Language, society and identity*. Oxford: Blackwell,.
- EDWARDS, J., (2009) *Language and identity: An introduction*. Cambridge University Press,
- EHALA, M., (2010), “Refining the notion of ethnolinguistic vitality.” *International journal of multilingualism* 7.4 363-378.
- GECEO, D. W., & GECEO K. A. W., (1999), “Adult education, language change, and issues of identity and authenticity in Kwara’ae (Solomon Islands).” *Anthropology & education quarterly* 30.1: 22-36.
- GILES, H., (1977), “Towards a theory of language in ethnic group relation.” *Language, ethnicity and intergroup relations*, Grossman, Jeffrey. “Wilhelm von Humboldt’s Linguistic Ideology: The Problem of Pluralism and the Absolute Difference of National Character: Or, Where

- Do the Jews Fit in?." *German Studies Review* 20.1 ; 23-47.
- HALE,K., ET AL., (1997), "Endangered Languages." *Language*, vol. 68, no. 1, 1992, pp. 1-42. 1991.
- HALL,S., (1993),. *Representation: cultural representations and signifying practices*. Vol. 1997. London: Sage, Harris,Randy Allen. *The linguistics wars*. Oxford University Presson Demand.
- HYMES, D., (1972),"On communicative competence." *Sociolinguistics* 269293: 269-293.
- LANDRY, R.,& RICHARD Y. B., (1997):"Linguistic landscape and ethnolinguistic vitality: An empirical study." *Journal of language and social psychology* 16.1 23-49.
- MAY,S., (2013),. *Language and minority rights: Ethnicity, nationalism and the politics of language*. Routledge.
- MONTRUL, S., (2016). *The acquisition of heritage languages*. Cambridge University Press,
- MOSELEY,CH., (2010), *Atlas of the World's Languages in Danger*. Unesco,
- SKËNDERI ,E., 2021, . *Qasje metodologjike të gjuhësisë së sotme*. Akademia e të Rinjve. Tiranë. 2021.
- SKUTNABB-KANGAS, T., (2001), "The Globalisation of (Educational) Language Rights." *International Review of Education / Internationale Zeitschrift Für Erziehungswissenschaft / Revue Internationale de l'Education*, vol. 47, no. 3/4, , pp. 201-19. JSTOR.
- SMEETS, R., (2004), "Language as a vehicleof the intangible cultural heritage." *Museum international* 56.1-2 156-165.
- SPOLSKY,B., (2023),."Language in Its Social Context." *Journal of Baltic Studies*, vol. 36, no. 3, 2005, pp. 254-72. JSTOR, <http://www.jstor.org/stable/43212647>. Accessed 21 Feb.
- UNDERHILL, J. W., (2012). *Ethnolinguistics and cultural concepts: Truth, love, hate and war*. Cambridge University Press,
- UNDERHILL, J. W., (2009), *Humboldt, world view and language*. Edinburgh University Press,
- UNESCO, (2003), "Text of the Convention for the Safeguarding of the Intangible Cultural Heritage", UNESCO. "Universal Declarationon Cultural Diversity", 2001.
- VONHUMBOLDT, W., (1999) dhe Wilhelm Freiherr von Humboldt. *Humboldt: 'On language': On the diversity of human language construction and its influence on the mental development of the human species*. Cambridge University Press,
- WITHERSPOON,G., (1980): "Language in culture and culture in language." *International Journal of American Linguistics* 46.1 1-13.
- WRIGHT,S., (2001): "Language and power: Background to the debate on linguistic rights." *International Journalon Multicultural Societies* 3.1 44-54.